KONTRATE

PER THEMELIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"ARVI" SH.P.K.

Personat qe firmosin me poshte :

Z.Spiro Nini i biri i Fotos dhe i Agusteles , i datelindjes 1935 , lindur ne Kudher , banues ne Durres , Rr."Q.Stafa" P.1021

Znj.Ardiana Shima e bija e Bajramit dhe e Xhevries , datelindjes 7 prill 1968 lindur e banuese ne Durres Lagjia 18. Rr. Jeta e Re

Kane hartuar si me poshte vijon kontraten e themelimit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar .

Shoqeria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne menyre te vecante me ligjin Nr.7638 dt. 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise si dhe me dispozitat e Statutit qe i bashkangjitet kesaj kontrate themelimi

Emertimi i shoqerise eshte "ARVI" SH.P.K.

Selia e shoqerise ndodhet ne Durres , Rr."Q.Stafa" P.1021

Shoqeria do te kete objekt te veprimtarise se saj :

* Punime dheu , murature betoni beton-arme te zakonshme , punime shembjesh
* Ndertime civile , industriale , turistike , bujqesore etj , kompletimin e instalimeve te nevojshme per to , punime hidraulike
* Te prodhoje , perpunoje e tregtoje materiale inerte , materiale ndertimi me pakice e shumice .
* Ushtrimin e veprimtarise private ekonomiko-tregtare , ne fushen e tregtimit me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale e ushqimore .
* Ushtrimin e veprimtarise private ne fushen e ushqimit social
* Ushtrimin e veprimtarise private ne fushen e industrise
* Ushtrimin e veprimtarise private ne fushen e transportit
* Ushtrimin e veprimtarise private ne fushen e import - eksportit te artikujve qe lidhen me aktivitetet e mesiperme
* Blerje ,shitje dhe shkembim valutash e letrash me vlere

Kohezgjatja e shoqerise do te jete mbi 10 vjet.

Kapitali themeltar do te jete 100.000 (njeqindmije) leke i ndare sipas kontributit te ortakeve 50.000 me 50.000 leke

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjese plotesisht te shlyera me vlere 1000 leke secila te renditura sipas numrit te serise nga 1 deri ne 100.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar , shlyer plotesisht dhe jane shperndar ndermjet ortakeve si me poshte:

1- Z.Spiro Nini 50%

2- Znj.Ardiana Shima 50%

Shuma e kapitalit themeltar derdhet ne nje nga bankat e Durresit nga te dy ortaket ne nje llogari te hapur ne emer te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ARVI" SH.P.K.

Shuma e depozituar do te vertetohet me ane te nje certifikate te leshuar nga ajo banke ne te cilen do te shenohen emrat e ortakeve , pjeset e kapitalit themeltar te nenshkruara e derdhura nga secili prej tyre.

Personat qe firmosin kete kontrate pasi kane marre dijeni per kete certfikate vertetojne se shumat e derdhura prej tyre jane ne perputhje me ato qe shenohen ne certifikat , dhe se ato e konfirmojne nenshkrimin e pjeseve te kapitalit themeltar ne perputhje me shumat respektive te derdhura.

Administratori i shoqerise do te jete Ing.Robert Sako te cilit i jane besuar te gjitha plotefuqite e administrimit te zakonshem dhe te jashte–zakonshem , perjashtuar ato qe ligji dhe Statuti ia rezervojne Asamblese .
dministratori eshte i emeruar per tre vjet duke filluar nga emerimi i tij dhe mund te cemerohet nga Asambleja. Adminisratorit i jepen te gjitha kompetencat te cilat ai i pranon , per te kryer te gjitha formalitetet e themelimit .
Ai gjithashtu eshte i autorizuar te veproje ne emer te shoqerise qe do te krijohet deri ne regjistrimin e saj ne Gjykaten e Rrethit Tirane .
Ai eshte i paisur me mandat per te kryer akte dhe per te marre angazhime ne emer dhe per llogari te shoqerise, te cilat i kalojne shoqerise nga casti i regjistrimit . Pervec te tjerave administratori eshte i ngarkuar te kryej akte dhe angazhime qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise dhe kompetencat e tij. Pas regjistrimit keto akte dhe angazhime i nensh–trohen miratimit te ortakeve jo me vone se data e mbledhjes se Asamblese qe shqyrton dhe vendos mbi llogarite e vitit te pare financiar. Ky mira–tim ben automatikisht kalimin e ketyre akteve dhe angazhimeve ne ngarkim te shoqerise.
Administratori eshte njekohesisht edhe drejtues teknik i punimeve.

Viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise dhe mbaron me 31 dhjetor 1996 .

Kjo kontrate themelimi eshte hartuar ne Durres me.............1996 , ne kater ekzemplare origjinal duke patur fuqi te barabarte ligjore.

PALET

Z. Spiro Nini

Znj. Ardiana Shima

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
ZYRA E NOTERISE
T I R A N E
Nr...827....Rep
Nr...340....Kol

V E R T E T I M

Sot me date 25.01.1996 , ne Zyren e Noterise Tirane , u paraqiten personalisht para meje ortaket i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ARVI" SH.P.K. Z.Spiro Nini i biri i Fotos dhe i Agusteles , i dtl 1935 , lindur ne Kudher , banues ne Durres , Rr."Q.Stafa" P.1021 dhe Znj. Ardiana Shima e bija e Bajramit dhe e Xhevries , datelindjes 7 prill 1968 lindur e banuese ne Durres Lagjia 18. Rr. Jeta e Re , te panjohur prej meje per identitetin e te cileve u sigurova nga leternjoftimet personale , madhore dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, te cilet me deklaruan se kontrata e themelimit e mesiperme eshte perpiluar sipas vullnetit te tyre te lire dhe te plote dhe une noterja e nenshkrova ate ne baze te ligjit.

Nr pasaporte Spiro Nini
0060057
Nr pasaporte Ardjana Shima
218479

N O T E R

Violeta Frasheri

BULLE TAKSE 10 LEKE

# S T A T U T I
## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
## "ARVI" SH.P.K. TIRANE.

Personat qe firmosin me poshte :
Spiro Nini i biri i Fotos dhe i Agusteles , i datelindjes 1935 ,
lindur ne Kudher , banues ne Durres , Lagjia 1 Rr."Q.Stafa" P.1021
Ardiana Shima e bija e Bajramit dhe e Xhevries , datelindjes 7.4. 1968
lindur e banuese ne Durres Lagjia 18. Rr. Jeta e Re
Kane hartuar si me poshte vijon Statutin e nje shoqerie me pergjegjesi
te kufizuar te cilen ne baze te Kontrates se Themelimit kane rene dakort
ta themelojne ndermjet tyre :

KREU I

FORMA , EMERTIMI , OBJEKTI , SELIA , KOHEZGJATJA .

Neni 1
Krijohet nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e cila e ushtron veprimta
ne e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne menyre te veca
e me ligjin Nr.7638 dt. 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe aktet e tjera
igjore qe
do te jene ne fuqi gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise si dhe me
spozitat e ketij Statutit
Neni 2
Emertimi i shoqerise eshte "ARVI" SH.P.K.
Neni 3
Shoqeria do te kete objekt te veprimtarise se saj :
* Punime dheu , murature betoni beton-arme te zakonshme , punime
shembjesh
* Ndertime civile , industriale , turistike , bujqesore etj ,
kompletimin e instalimeve te nevojshme per to , punime hidraulike
* Te prodhoje , perpunoje e tregtoje materiale inerte , materiale
ndertimi me pakice e shumice .
* Ushtrimin e veprimtarise private ekonomiko-tregtare , ne fushen e
tregtimit me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale e
ushqimore .
* Ushtrimin e veprimtarise private ne fushen e ushqimit social
* Ushtrimin e veprimtarise private ne fushen e industrise
* Ushtrimin e veprimtarise private ne fushen e transportit
* Ushtrimin e veprimtarise private ne fushen e import - eksportit te
artikujve qe lidhen me aktivitetet e mesiperme
* Blerje ,shitje dhe shkembim valutash e letrash me vlere.
Neni 4
Selia e shoqerise ndodhet ne Durres , Lagjia 1 Rr."Q.Stafa" P.1021
Transferimi i selise se shoqerise behet me miratimin e ortakeve.
Neni 5
Kohezgjatja e shoqerise do te jete mbi 10 vjet

KREU II

KAPITALI THEMELTAR , KONTRIBUTET , PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

Neni 6
Kapitali themeltar do te jete 100.000 (njeqindmije) leke .
Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjese plotesisht te shlyera me
vlere 1000 leke secila te renditura sipas numrit te serise nga 1 deri
ne 100.

Fondet qe rrjedhin nga shlyerja e pjeseve depozitohen ne nje nga bankat
e Durresit nga te dy ortaket ne nje llogari te hapur ne emer te shoqe-
rise me pergjegjesi te kufizuar "ARVI" SH.P.K.
Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet pjeseve te reja ortaket
kane te drejten e perparesise ne nenshkrimin proporcionalisht me shumen
e pjeseve te tyre ,por ato jane te lire te heqin dore nga kjo e drejte .
Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin e saj . Zvogelimi i kapitalit vendo-
set nga Asambleja e Ortakeve . Zvoglimi i kapitalit prek te gjithe or-
taket ne te njejten mase.

Neni 7

Kapitali themeltar perbehet nga kontributet e meposhtme:
Z.Spiro Nini kontribuon me shumen 50.000 leke ose 50%
Znj.Ardiana Shima kontribuon me shumen 50.000 leke ose 50%
Ne te drejtat dhe detyrimet ortaket jane te barabarte .

Neni 8

Ne baze te kontributeve te siperpermendura :
Z.Spiro Nini disponon 50 pjese te kapitalit themeltar te rendituara nga
numri 1 deri ne numrin 50
Znj.Ardiana Shima disponon 50 pjese te kapitalit themeltar te rendítura
nga numri 51 deri ne numrin 100
Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar nenshkruhen plotesisht dhe pastaj
shperndahen ndermjet ortakeve sipas ndarjes se mesiperme .

Neni 9

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet orta-
keve , ne rruge trashigimie , ne rast ndarjesh pasurore ndermjet bashke-
shorteve dhe ndermjet paraardheseve dhe pasardheseve .
Pjeset e kapitalit themeltar mund ti transferohen te treteve vetem me mir
timin e ortakut tjeter dhe jo ne kushte me te favorshme se ato me te cila
i jane ofruar me pare ortakut tjeter

KREU III

MARRJA E VENDIMEVE DHE KONTROLLI I SHOQERISE , ADMINISTRIMI

Neni 10

Oratket e shoqerise perballojne humbjet e saje deri ne kufirin e vleres
se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.
Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe vendimet e Asam-
blese dhe disponon nje numer votash te barabart me pjeset e kapitalit
themeltar qe ai zoteron . Ne ushtrimin e se drejtes se pjesmarrjes ne
mbledhjet e Asamblese cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga ortaku
tjeter , nga bashkeshorti ose nga nje person tjeter i autorizuar dhe
paisur me prokure prej tij.
Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga nje ose disa ortake qe zoterojne
mbi 1/10 e pjeseve te kapitalit themeltar , nga administratori , nga ek-
spertet kontabel te autorizuar , po qe se ka te tille ose nga likujduesi.
Sipas rendesise se vendimeve mbledhja e Asamblese mund te jete e zakon-
shme ose e jashtzakonshme Asamblese e zakonshme vendos per ceshtje te
tilla si ; emerimin ose shkarkimin e administratoreve , eksperteve kon-
tabel te autorizuar dhe likujduesve , miratimin e raporteve te adminis-
trimit dhe kontrollit , miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjen e fi-
timit , etj . Asamblese e jashtzakonshme vendos per ceshtje te tilla
si ; ndryshime te Statutit , zvogelimi i kapitalit themeltar , transfe-
rimin e kapitalit themeltar tek te tretet , zgjatjen e kohes se veprim-
tarise se shoqerise apo likujdimin e saj , shnderrimin e shoqerise nga
SH.P.K. ne nje forme tjeter te shoqerive tregtare ,etj .

Neni 11

Administratori i shoqerise do te jete Ing.Robert Sako te cilit i jane